

THIRRJA PËR TË BESUAR

Te Luka 18 Jezusi bëri një pyetje hetuese: “. . . kur të vijë Biri i njeriut, a do të gjejë besim mbi tokë?” (v. 8).

Jetojmë në një epokë trazirash dhe shqetësimesh. Sa herë që lexojmë gazetën apo dëgjojmë radion ose televizorin ndërgjegjësohemi për këtë fakt. Çdo njeri duket se ka pyetje, por pak kanë përgjigje. Shpesh “e vjetra” flaket tutje dhe asgjë e përhershme nuk vjen ta zëvendësojë atë, duke rezultuar kështu në një vakum kaotik.

Në një epokë të tillë është i paevitueshëm sulmi ndaj besimeve të cilat ishin aq të rëndësishme për njerëzit në të kaluarën. Kemi parë sulme direkte ndaj besimit të Perëndia. Njerëzimi dukshëm ka arritur pikën në të cilën shumë nuk e ndiejnë më nevojën e madhe për Perëndinë.

Sulme të vazhdueshme i janë bërë besimit se Bibla është Fjala e Perëndisë. Shkolla moderne të kritikës e “përmirësojnë” Biblën deri sa asgjë nuk mbetet nga Fjala e vërtetë e Perëndisë në të. Ato tallen me konceptin e frymëzimit të Biblës nga Perëndia.

Vazhdojnë gjithashtu edhe sulmet ndaj hyjnisë së Jezusit. Këto janë më të maskuara, sepse shumë i bëjnë lajka Jezusit si superprofet, supermësues, supernjeri apo superstar. Pasi çdo gjë është shqyrtuar, njerëzit që kanë këto pikëpamje akoma nuk e njohin Jezu Krishtin si Zotin e jetës, në këmbët e të cilit çdo njeri duhet të përkulet.

Një rezultat praktik i këtij mosbesimi ka qenë sulmi ndaj çdo standarti të së drejtës apo të së gabuarës. Njerëzit kanë shpikur “etikën operative”. Nuk mbështetemi më në standartet e Perëndisë, të Biblës apo të Krishtit për çështjet e të drejtës apo të së gabuarës. Njeriu e ka bërë *veten* gjykatës dhe “ligji” i tij i vetëm është “ligji i dashurisë së vetvetes”.

Pra, sa me vend janë fjalët e Krishtit në epokën tonë! “Kur të vijë Biri i njeriut, a do të gjejë besim mbi tokë?”

Në këtë mësim duam të bëjmë një pyetje të rëndësishme: “A mund të besojë dikush te Perëndia, te Krishti dhe te Bibla në shekullin XXI?” Është qëllimi im të pohoj se besimi nuk është i dalë mode dhe se njeriu me arsye mund të besojë në mësimet e Biblës në shekullin XXI.

Kjo mund të demonstron në disa mënyra, por dua t’ju drejtoj në një vijë mendimi, t’ju sugjeroj se është *logjike* të besosh në shek. XXI. E vërteta kurrë nuk mund të zbulohet vetëm nga arsyeja. Kur dikush bëhet kristian, Perëndia nuk pret që ai të braktisë logjikën apo aftësinë e të menduarit.

Studimi ynë do të ndërtohet si një zinxhir, në seri hallkash të lidhura me njëra-tjetrën. Kur të përfundojmë studimin tonë, mund të rishikoni ato hallka, tashmë të shpjeguara dhe të qarta dhe të shqyrtoni besimin *tuaj*. Në një moment mund të thoni: “Mund të shkoj deri këtu dhe jo më tutje.” Flisni për këtë me personin që ua dha këtë botim. Kjo do të japë bazat për studim të mëtejshëm.


ËSHTË LOGJIKE TË BESOJMË SE KA NJË PERËNDI

Psalmeve 14:1a thotë: “I pamendi ka thënë në zemër të tij: «Nuk ka Perëndi».” (Shikoni edhe te Psalmeve 53:1.) Autori këtu nuk e ka fjalën për mungesën e inteligjencës, por për budallallëkun e njeriut që nuk i hap sytë ndaj sasisë së madhe të provave përreth tij, që provojnë ekzistencën e Perëndisë.

Psalmeve 19:1 thotë: “Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij.” Romakëve 1:20 thotë: “Në fakt cilësitë e tij [të Perëndisë] të padukshme, fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij, duke qenë të padukshme nëpërmjet veprave të tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pafalshëm.”

Kur isha djalë i vogël, predikuesit shpesh përdornin një ilustrim të thjeshtë. Ata hiqnin orën e dorës dhe e tregonin (ekspozonin) atë, duke këmbëngulur se tamam ashtu si ora shpall ekzistencën e orëbërësit, ashtu edhe kjo botë shpall ekzistencën e Krijuesit të saj. Ky ilustrim është i shkëlqyer, por nganjëherë njerëzit nuk e kuptojnë gjithë domethënien e tij.

Në qoftë se do të jepnim një argument të plotë për ekzistencën e Perëndisë, do të filloja me ndërtimin e një piramide me tre nivele. Do ta quaja nivelin bazë (1) *ekzistenca*. Niveli mbi të do të ishte (2) *rregulli* dhe niveli i sipërm do të ishte (3) *plani apo qëllimi*.



Do ta sqaroj shkurtimisht secilin nivel, duke përdorur ilustrimin e orës së dorës.

Ekzistenca. Ora ekziston. Ja ku është. Prania e saj është realitet. Duhet të ketë ardhur prej diku.

Rregulli. Ora, jo vetëm që ekziston, por ajo funksionon sipas një rregulli. Ajo përbëhet nga mekanizma të dhëmbëzuar, susta dhe pjesë të tjera të vëna së bashku që funksionojnë si një njësi e vetme. (Bëhet fjalë për një orë mekanike. Shqyrtimi i një ore elektronike do të ishte, edhe ai, shumë i përshtatshëm.) Për sa kohë që të gjitha pjesët funksionojnë siç duhet, ajo funksionon në një mënyrë të rregullt e të saktë.

Qëllimi. Ora, jo vetëm që punon me rregull, por ajo përmbush kështu një qëllim. Cilido që ta ketë bërë atë ka patur në mendje një funksion të përcaktuar për të dhe ajo në përgjithësi e përmbush këtë qëllim. Ajo tregon kohën e saktë.

Në të njëjtën mënyrë, ndërsa shikojmë universin, këto janë tri linjat kryesore të provës për besimin në një Krijues: (1) Universi *ekziston*. (2) Më tej, universi vepron në bazë të *rregullave* të caktuara. Ne e masim kohën duke u bazuar në kronometrin e madh qiellor të Perëndisë. (3) *Qëllimi* i universit duket në çdo fije bari, në çdo pemë.

Argumenti më i zakonshëm kundër ekzistencës së Perëndisë është në të vërtetë kundër dy niveleve të sipërme, *rregullit* dhe *qëllimit*. Dikush

mund të tregojë përmbytjet, uraganet, tërmetet apo ndoshta një tragjedi personale në jetën e tij. Për shkak të këtyre, ai nxjerr përfundimin se nuk ka Perëndi. Megjithatë, ky përfundim nuk është i drejtë.¹

Koha nuk na lejon që të shqyrtojmë secilën nga këto linja mendimi në thellësi. Prandaj, do të përqëndrohemi në bazën e piramidës, *ekzistencën*.

Le të kthehemi te shembulli i orës. Po sikur të gjeni një orë të prishur në rrugë? Imagjinoni sikur t'i ketë rënë dikujt dhe madje të jetë e shkelur. Ajo nuk e tregon më orën e saktë. Ndoshta nuk punon fare. *A do të thotë kjo se nuk ka më orëbërës?* Jo, prova është akoma aty, e qartë dhe e pagabueshme, edhe në atë gjendje të dëmtuar. Ora akoma *ekziston*.

Meqënëse ekziston, prej nga erdhi?

Është thënë se ka vetëm dy lloj ekzistencash: shpirti dhe materia. Meqënëse diçka nuk mund të vijë nga asgjëja, njëra duhet të kenë qenë e përjetshme dhe ka krijuar tjetrën. Ose shpirti ka ekzistuar gjithmonë dhe ka krijuar materien, ose materia ka qenë e përjetshme dhe ka krijuar shpirtin. Meqënëse është e pamundur që materia jo e gjallë, e pamend dhe amorale të mund të ketë krijuar shpirtin e gjallë, të arsyeshem dhe emocional, me një ndërgjegje morale, atëherë duhet të ketë qenë e kundërta. Shpirti i përjetshëm duhet të ketë krijuar materien.

Një miku im, Xhim Ualdron, bëri ilustrimin e mëposhtëm. Ai ishte në aeroplan duke shkuar për në Pakistan dhe vuri re se ishte ulur pranë një rusi. Ata filluan të bisedonin dhe shpejt biseda u kthye te çëshjet fetare. Rusi nuk mund të besonte se Perëndia e ka krijuar botën. Më në fund Xhimi e pyeti: “A bëjnë fëmijët e vegjël në Rusi kukulla prej balte (plasteline)?” Burri buzëqeshi dhe e pranoi se në Rusi fëmijët e vegjël bëjnë kukulla prej balte.

Xhimi i tha: “Shumë interesante. Edhe në vendin nga vij unë fëmijët bëjnë kukulla prej balte. Në fakt, kudo ku kam qenë në botë fëmijët bëjnë kukulla prej balte. Por diçka nuk e kam parë asnjëherë. *Nuk kam parë kurrë një kukull prej balte të bëjë një fëmijë të vogël.*”

Bashkëbiseduesi i Xhimit e kuptoi shumë shpejt tani kuptimin e “shpirtit” dhe “materies”. Shpirti ka aftësinë të përpunojë dhe të përdorë materien. E ansjellta nuk ndodh. Xhimi përfundoi

duke buzëqeshur: “Personalisht, më duket më e lehtë të besoj se fëmijët bëjnë kukulla prej balte sesa të besoj se kukullat prej balte bëjnë fëmijë.”

Meqënëse diçka ekziston, diçka tjetër duhet të ketë ekzistuar përgjithmonë, sepse asnjë gjë nuk mund të dalë nga hiçi. A ka qenë gjithmonë kjo botë apo është krijuar në një moment të caktuar?

Para disa vjetësh, më pëlqeu shumë leximi i një libri të titulluar “*Prova e Perëndisë në një univers të tejshtirë*” shkruar nga dyzet shkencëtarë të fushave të ndryshme. M’u duk ineresante se si shumë prej tyre përdorën prova nga fushat e tyre të ndryshme të kërkimit për të treguar se ky univers po “vjetërohet”. Është krahasuar në mënyra të ndryshme me një zjarr që po shuhet, një fugë që po ndalon dhe shumë ilustrime të tjera. Sido që ta thoni, dy të vërteta janë evidente: (1) universi nuk është i përjetshëm dhe (2) universi filloi një moment të caktuar në kohë.²

Meqënëse diçka nuk mund të vijë nga hiçi, kjo na bën të mendojmë për një forcë të mjaftueshme që krijoi universin. Kjo forcë duhet të jetë një lloj shpirti i përjetshëm, me fjalë të tjera, Perëndia.

Shikoni përreth. A u krijua nga hiçi shtëpia ku banoni? Hebrejve 3:4 e përmbledh mirë këtë çështje: “Sepse çdo shtëpi ndërtohet prej dikujt, por ai që ka ndërtuar gjithçka është Perëndia.”³

ËSHTË LOGJIKË TË BESOJMË SE PERËNDIA KRIJOI GJITHÇKA

Kemi treguar shenjat e pagabueshme se ky univers është *i krijuar* me qëllim që të tregojmë se është logjike të besojmë se ai e ka një *Krijues*. Tani, le ta shikojmë këtë mendim nga ana e kundërt. Ky Krijues në të vërtetë e krijoi universin. Universi nuk doli rastësisht. Ai u krijua, u rregullua dhe u ndërtua.

Le të shkojmë në thelb të çështjes. Meqënëse është logjike të besojmë se Perëndia bëri çdo gjë, është logjike gjithashtu të besojmë se Perëndia bëri edhe njeriun. Zoti na bëri të gjithëve.

Kur tregova për piramidën më lart, u ruajta nga zbatimi i këtyre “provave” në rastin e vetë njeriut. Megjithatë, e konsideroj qenien njerëzore shembullin më të mirë për atë që po flisja.

Shikoni veten për një moment. Nuk ka asnjë makineri si trupi njerëzor. Nuk ka asnjë pajisje



mekanike si dora njerëzore.⁴ Nuk ka asnjë kamera si syri i njeriut. Nuk ka asnjë pompë si zemra e njeriut. Nuk ka asnjë ambalazhim si lëkura vetëftohëse dhe vetëshëruese e njeriut. Nuk ka asnjë fabrikë si organet e brendshme të njeriut. Sipas fjalëve të Davidit, “jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme” (Psalmëve 139:14).

Merrni mendjen njerëzore si shembull. Jetojmë në epokën e kompjuterave të mahnitshëm. Por në qoftë se do të mund të ndërtonit një kompjuter të madh sa një gradaçelë, ai prapë nuk mund t’i afrohej as potencialit, shkathtësisë apo origjinalitetit të trurit të një fëmije të vogël.

Teoria e evolucionit thotë se kemi evoluar nga format më të ulta të jetës. Sipas kësaj teorie, mendja jonë është zhvilluar, sepse ne nuk ishim aq të fortë, të shpejtë apo të mëdhenj sa të konkuronim me kafshët e tjera të këtyre niveleve. Megjithatë, e vërteta është se ne zhvillojmë vetëm përqindjen më të vogël të potencialit të trurit që kemi. Përparimi dhe progresi i njeriut nuk mund të shpjegohet nga asnjë teori “mbijetese”. Fakti i thjeshtë është se Perëndia na dha mendjen. Një Qenie që mendon na krijoi si qenie që mendojmë.

E përsëris, është logjike të besosh se Perëndia e krijoi njeriun. Është shumë më e arsyeshme të besosh se ne jemi krijuar sipas shembëlltyrës së Perëndisë (Zanafilla 1:26) sesa sipas shembëlltyrës së një krijese stërgjyshore si majmuni.

ËSHTË LOGJIKË TË BESOJMË SE PERËNDIA IA BËRI TË NJOHUR VULLNETIN E TIJ NJERIUT

Në qoftë se Perëndia e bëri këtë botë, është logjike që ai t’i jepte njeriut informacion se nga ka ardhur, pse ndodhet në këtë botë dhe cili është qëllimi i jetës së tij.

Përfytyroni sikur të vini në shtëpi një ditë dhe para derës të gjeni një pjesë të stërmadhe makinerie që shkëlqen. Ajo është e komplikuar dhe e prodhuar në zbatim të fjalës së fundit të

shkencës. Duket se është projektuar për një funksion shumë të rëndësishëm. Megjithatë, nuk ka gjurmë që të tregojnë qëllimin e saj. Nuk ka manual përdorimi dhe as ndonjë informacion të shkruar në të. Le të themi se nuk do ta merrni vesh kurrë se për çfarë ishte krijuar aparati. Ka mundësi të arrini në njërin prej dy konkluzioneve: (1) Ose ai që e bëri ka vdekur para se të bëjë të njohur qëllimin e pajisjes, ose (2) ai që e bëri ishte i çmendur.

Ndërsa shikojmë këtë botë përreth nesh, shumë më të ndërlëkuar dhe më komplekse se çdo makineri që njeriu ka bërë ndonjëherë, mund të arrijmë gjithashtu në përfundimin se, në qoftë se Krijuesi nuk ka komunikuar me ne për të na treguar se për çfarë është jeta, ai është ose i vdekur ose i çmendur. Perëndia nuk është as i vdekur, as i çmendur. Si rrjedhim, arrijmë në konkluzionin se Perëndia ka komunikuar, dhe se fjalët kyç të Hebrenjve 1:1, 2 janë plotësisht logjike: “Zoti, . . . ka folur. . . .”

Në qoftë se Perëndia ka komunikuar, kjo do të thotë se ai ka vendosur disa standarte, sipas të cilave disa gjëra janë të drejta dhe disa të gabuara. Njeriu nuk mund t’i vendosë këto standarte. Bibla thotë: “. . . rruga e njeriut nuk varet nga fuqia e tij dhe njeriu që ecën nuk ka fuqi të drejtojë hapat e tij” (Jeremia 10:23).

Ç’ mjet përdor Perëndia për të komunikuar me njeriun? Libra të ndryshëm sot pretendojnë të jenë të frymëzuar nga një fuqi e lartë, duke kundërshtuar njëri-tjetrin në pika të ndryshme. Por ne duhet të përcaktojmë me saktësi mjetin me anë të cilit Perëndia zgjodhi t’i bëhej i njohur njeriut. Le ta shtjellojmë më tej mendimin. Është logjike të besojmë se ky mjet është Bibla, se Perëndia vendosi t’i bëhej i njohur njeriut me anë të Biblës.

Prova të panumërta tregojnë për frymëzimin e Biblës nga Perëndia. Prova të tilla janë: uniteti, lashtësia, modernizmi, saktësia historike dhe gjeografike, qartësia, ndikimi, paprishshmëria, profecitë e përmbushura dhe të tjera. Për shkak të kohës së kufizuar, le të qëndrojmë te vija e mendimit që tashmë kemi nisur. Mendoni për këtë: në qoftë se Perëndia e krijoi botën dhe pastaj i dha njeriut një zbulesë të vullnetit të tij, a nuk është logjike që zbulesa e dhënë do të ishte ajo që do ta përgatiste më mirë njeriun për të

jetuar në botën e krijuar prej Perëndisë?⁵

Shikojeni botën si e tërë. Dalloni ato vende ku njeriu ka përparuar më shumë, ku nevojat e njerëzve janë plotësuar më mirë, ku jeta njerëzore mbrohet dhe respektohet më shumë. Do të shikoni se, në të kaluarën të paktën, Bibla ka patur influencë më të madhe pikërisht në ato vende.⁶

Fjalët e Palit janë vërtetuar në të gjithë botën: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë” (2 Timoteut 3:16, 17).

Bibla ka në vetvete prova bindëse, që na tregojnë se është e frymëzuar nga Perëndia. Në qoftë se e keni të vështirë të besoni se Bibla është vërtet prej Perëndisë, do t’ju sugjeroja që t’i drejtoheni vetë librit dhe të njiheni nga afër, duke e studiuar atë. Pali tha: “Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë” (Romakëve 10:17).

Për ta ilustruar, le të imagjinojmë se kam frikë nga hajdutët dhe mbaj një pistoletë poshtë jastëkut. Le të përfytyrojmë më tej se një natë ngrihem për të gjetur hajdutin. Dua ta frikësoj që të largohet duke i treguar fuqinë a armës. Çfarë mund të bëj?

Mund të veprojmë të paktën në dy mënyra. Mund të ndez dritat, t’i tregoj armën dhe t’i them: “E shikon këtë pistoletë? Ka një grykë bosh. Këtu poshtë futet fisheku. Fisheku ka një gëzhoje dhe barut, si edhe një saçme plumbi në majë. Në qoftë se do të tërhiqja këmbëzën, kjo do të aktivizonte gjilpërën që do të godiste fishekun me një forcë të madhe. Baruti do të shpërthente dhe saçmja do të dilte nga gryka e armës dhe do të hapte një vrimë në trupin tënd, po ta drejtoja nga ti.”

Nga ana tjetër, mund të qëlloj disa herë në ajër. Kjo do të jetë një mënyrë më efektive.

Mund të flasim shumë për Biblën, por duhet të mbajmë në mendje se Bibla është e fuqishme. Ajo është “e gjallë dhe vepruese, më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe” (Hebrenjve 4:12). Ajo ka ndryshuar drejtimin e jetës së njerëzve, të kombeve dhe të historisë.

Në qoftë se me të vërtetë dëshironi provën themelore se Bibla është nga Perëndia, jepini rast ta tregojë veten në jetën tuaj. Lexojeni dhe studiojeni atë. (Dua të them studiojeni me të

vërtetë.) Zbatojeni në jetën tuaj. Do të shikoni se ajo ka tingullin e së vërtetës.

ËSHTË LOGJIKE TË BESOJMË SE PERËNDIA E DO NJERIUN DHE DËSHIRON QË TA NDIHMOJË

Ndërsa shikojmë përreth në botën tonë, është e pamundur të mos impresionohemi nga fakti se Perëndia është një Perëndi personal që preokupohehet për të gjitha nevojat tona. Megjithatë nuk mund ta kuptojmë plotësisht dashurinë e Perëndisë, Perëndia na do.

Perëndia mund ta kishte bërë këtë botë shumë funksionale, për të kënaqur nevojat e mishit dhe kaq, por nuk e bëri. Ai e bëri atë të bukur. Ai bëri lulet. Ai bëri zogjtë plot ngjyra. Çdo gjë që bëri ishte “shumë mirë” (Zanafilla 1:31).

Në kopshtin e Edenit Perëndia vendosi llojlloj pemësh që ishin (1) “të këndshme nga pamja” dhe (2) “të mira për t’u ngrënë” (Zanafilla 2:9). Kur bëri një “ndihmës që i leverdiste” burrit, Perëndia mund të kishte bërë një copë mishi të aftë për të bërë fëmijë. Përkundrazi, ai bëri një krijesë të bukur, për të hijeshuar jetën e burrit.

Ndërsa mendojmë për nevojat e njeriut, vijmë si përfundim te nevojat morale dhe shpirtërore. A nuk ka ndjerë gjithësecili në një moment apo në një tjetër dëshira shumë të forta shpirtërore? A mund të thotë dikush se ai gjithmonë i ka plotësuar parimet e Perëndisë? A nuk është ndjerë gjithësecili nganjëherë i pashpresë dhe në nevojën e një Qenieje më të madhe se veten? Bibla thotë: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë” (Romakëve 3:23).

Duke njohur, pra, dashurinë dhe shqetësimin e Perëndisë, nuk habitemi kur lexojmë në Bibël për ofertat që Perëndia na ka bërë. Ai e ka marrë dënimin për mëkatet mbi vete në personin e Birit të tij dhe na ka siguruar ndihmë të vazhdueshme shpirtërore nëpërmjet Jezusit. Le të themi thjesht se, në dritën e dashurisë së Perëndisë, vargje të tilla si këto janë logjike:

Sepse Perëndia e deshi aq Botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme (Gjoni 3:16).

... Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve (1 Korintasve 15:3, 4).

ËSHTË LOGJIKE TË BESOJMË SE PERËNDIA DËSHIRON NJË PËRGJIGJE

Megjithatë Perëndia na ka siguruar për mirëgenien shpirtërore, ai nuk na ka bërë robotë. Ai na ka dhënë udhëzime për të zbatuar, por gjithashtu na ka dhënë edhe vullnet të lirë. Ne kemi të drejtën për të zgjedhur. Mund të besojmë apo të mos besojmë. Mund të bindemi apo të mos bindemi. Mund të duam apo të urrejmë.

Perëndia na ka dhënë prova mbi të cilat mund të mbështesim besimin tonë. Ai e ka shprehur dashurinë e tij në mënyra të panumërta. A mendoni se nuk është logjike që ai të dëshirojë nga ne që t’i përgjigjemi kësaj dashurie me besim, bindje dhe dashuri?

- *Besim.* Te Hebrejve 11:6 thuhet: “Edhe pa besim është e pamundur t’i pëlqesh atij, sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është, dhe se është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë.”
- *Bindje.* Te Hebrejve 5:9 thuhet: “[Ai] u bë vepronjësi i shpëtimit të amshuar për të gjithë ata që i binden.”
- *Dashuri.* Te 1 Gjoni 4:8 thuhet: “Ai që nuk ka dashuri nuk e ka njohur Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri.”

Perëndia nuk na bëri robotë, sepse përgjigja e robotëve është mekanike, automatike, e pakuptimtë dhe e pavlerë. Përkundrazi, përgjigja e njerëzve me vullnet të lirë ka vlerë dhe kuptim.

Kur mendojmë për çdo gjë që Perëndia ka bërë për ne, është logjike që ai të dëshirojë dhe të presë përgjigjen e përmbledhur te Galatasve 5:6: “besim(i) që vepron me anë dashurie”.

Ky diskutim mund të zgjerohet, sepse Dhjata e Re është plot me informacion specifik lidhur me përgjigjen e dëshiruar dhe të kërkuar nga Perëndia. Mëgjithatë, tani për tani, le ta mbyllim këtë studim me një hallkë të fundit të linjës së mendimit tonë.

ËSHTË LOGJIKE TË BESOJMË SE PERËNDIA DO TA THËRRASË NJERIUN NJË DITË PËR TË DHËNË LLOGARI

Kudo përreth nesh na tregohet se kjo jetë nuk është gjithçka. Çdo racë duket se ka një sens të

vetëlindur të pavdekshmërisë. Edhe ata njerëz që janë larguar shumë nga Perëndia i vërtetë, e kanë mbajtur një koncept të një jete përtej jetës së tanishme.⁷

Duke patur parasysh jetën që do vijë, është logjike të besojmë se Perëndia do na thërrasë për të dhënë llogari për atë se si e përdorëm atë që na ishte dhënë në këtë jetë, bekimet, mundësitë dhe detyrat. Na është thënë: “E tjetra që kërkohet nga administratorët, është që secili të gjendet besnik” (1 Korintasve 4:2).

Bibla e quan kohën e dhënies llogari “ditë e gjykimit”. Te Hebrejve 9:27 thuhet: “Dhe, duke qenë se është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe më pas vjen gjyqi.”

Besoj se koncepti i gjykimit është i arsyeshëm. Në këtë jetë “bilanci nuk është kënaqshëm”. Të këqinjët shpesh përparojnë. Të mirët janë shpesh të shtypur. Të fajshmit shpesh nuk vuajnë asnjë dënim, ndërsa të pafajshmit vuajnë. Sigurisht, në qoftë se ka një Perëndi, është logjike që një ditë të gabuarat do të ndreqen dhe drejtësia do të vendoset.

Kjo do të thotë se një ditë do të duhet të qëndrojmë përpara Perëndisë në kohën kur “secili nga ne do t’i japë llogari Perëndisë për veten e vet” (Romakëve 14:12).

KONKLUZION

Më poshtë jepen hallkat e zinxhirit të mendimit se është logjike të besojmë . . .

- se ka një Perëndi.
- se ai krijoi çdo gjë dhe se, veçanërisht, ai krijoi edhe njeriun.
- se ai i iu bë i njohur njeriut me anë të Biblës.
- se ai e do dhe e ndihmon njeriun, duke e ndihmuar atë nga ana shpirtërore nëpërmjet Krishtit.
- se ai dëshiron dhe pret një përgjigje.
- se njeriu do të thirret në fund për të dhënë llogari para Perëndisë për atë se si i ka përdorur bekimet shpirtërore dhe fizike si dhe mundësitë e tij.

Çfarë keni bërë së fundi për t’u bërë gati për atë ditë?

Ndërsa e mbylлим këtë mësim, le t’i kthehemi pyetjes së Jezusit: “Kur të vijë Biri i njeriut, a do të gjejë besim mbi tokë?” Megjithatë, le ta bëjmë pyetjen më personale: “Kur të vijë Biri i njeriut, a do të gjejë ai besim në zemrat tuaja?” Ky është aspekti më i rëndësishëm i pyetjes për ju.

Mund të jeni si njeriu që thirri: “Unë besoj, o Zot, ndihmo mosbesimin tim” (Marku 9:24). Në qoftë se ju mungon besimi apo është formal apo i pamjaftueshëm për t’ju bërë që t’ia kushtoni jetën tërësisht Perëndisë, ju inkurajoj të lexoni, të studoni dhe t’i bindeni Biblës, në mënyrë që Zoti, kur të vijë, të mund të gjejë në ju një besim që vepron me anë dashurie.

¹ Bota jonë është kryesisht një botë me rregull dhe qëllim. Ndërsa duhet të merremi me “problemin e së keqes” jobsimitari ka një sfidë më të madhe, të shpjegojë “problemin e së mirës” (t’i përgjigjet pyetjes: “Pse ekziston e mira në botë?”).

² Ka një teori “qarkullimi” sipas së cilës universi periodikisht e përtërin veten, por tani për tani kjo mbetet një teori pa baza që është në kundërshtim me provat e njohura të shkencës.

³ Koha nuk na lejon ta trajtojmë në thellësi këtë linjë interesante mendimi. Njëri prej shkrimtarëve të librit “*Prova e Zotit në një univers të tejshtrirë*” nënvizon se koncepti se çdo gjë në univers është e krijuar nga dikush, është një koncept natyral dhe jo i mësuar. Çdo fëmijë pyet: “Nga erdhi kjo? Kush e krijoi atë?”

⁴ Para pak kohësh pashë një program televiziv që tregonte për një projekt që kushtonte qindra mijëra dollarë. U desh shumë eksperiencë dhe trajnim për të vënë në funksionim një pajisje mekanike me një qëllim: të marrë dhe të zhvendosë kuti të thyeshme me lëndë radioaktive. Me fjalë të tjera, të mund të realizonte një nga funksionet e dorës së njeriut.

⁵ Bibla na tregon se kjo botë është vetëm një vend ndalimi në rrugën për në përjetësi, por mbetet akoma fakt se ndërsa jemi këtu, Perëndia na jep “jetë me bollëk”.

⁶ Në shumë prej këtyre vendeve, Bibla nuk ka më aq indikim. Megjithatë, meqënëse Bibla kishte ndikim më parë, kur filozofitë e jetës u formuan dhe drejtimit në të cilat do të ecin këto kombe u vendosën, pohimi mbetet i vërtetë.

⁷ Mendoni për ata që vendosin ushqime dhe gjëra të tjera në varre që të vdekurit t’i përdorin në jetën tjetër.

MENDIME PËR BESIMIN

“Besim do të thotë të besosh në fjalën e Perëndisë, në atë që nuk shohim, dhe shpërblimi i tij është të shohim dhe të shijojmë atë që besojmë.”

Augustin

“Besimi është zemra e mendjes.”

Anonime

“Gjithë puna që ia vlen është ajo e bërë me besim.”

Albert Schweitzer

“Nuk ka besim dhe vepra. Nuk ka besim apo vepra. Ka besim që vepron.”

Anonime

Autor: *David Roper*
Marrë nga studimi: “*Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve*”
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara